



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures



Arsimimi

KULTURA E NJERIUT

Ë-buletin



Dhjetor 2015

Takimi i Këshillit Drejtues të SBASHK-ut

Vërejtje të shumta ndaj institucioneve qendrore e lokale të shtetit



Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, por edhe anëtarët e Këshillit Drejtues duke përcjellë opinionet dhe zërin e mësimdhënësve nga gjithë komunat e Kosovës dhe nga Universiteti kanë bërë vërejtje të shumta në adresë të institucioneve qendrore e lokale të shtetit. Ata kanë kujtuar Kabinetin Qeveritar dhe organet e Universitetit se nëse nuk ka veprime konkrete lidhur me këto çështje atëherë do të ketë veprime (faqe 5)

Gjykata e Ferizajt u njeh të drejtën e kompensimit të tre pagave pensionistëve

Çështjet më mirë të zgjidhen me dialog se me gjykatë

Mos zbatimi i kontratës kolektive qon pensionistët që të drejtat e tyre që parashihen me....(faqe 7)

Intervistë me kryetarin e SBASHK-ut
z.Rrahman Jasharaj

Është krenari të punosh në shërbim të mësimdhënësve të Kosovës

Rrahman Jasharaj u zgjodh kryetar i SBASHK-ut në Kongresin e VI me 22 shkurt 2014. Me aktivitete sindikale ka nisur të merret ... (faqe 3)

Delegacioni i SBASHK-ut u takua me ministrin Bajrami

Bashkërisht do të angazhohemi edhe në vitin 2016



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj i shoqëruar nga menaxheri për financa dhe këshilltari për organizim... (faqe 6)

Takim miqësor dhe i suksesshëm i SBASHK-ut me përfaqësues të GIZ

Bashkëpunimi vazhdon edhe në vitin 2016



"Jam e impresionuar me angazhimin, korrektësinë tuaj, përkushtimin me zemër në shërbim të arsimit dhe me sukseset e Konferencës suaj ... (faqe 6)

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC





Intervistë me kryetarin e SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj

Është krenari të punosh në shërbim të mësimdhënësve të Kosovës



Rrahman Jasharaj u zgjodh kryetar i SBASHK-ut në Kongresin e VI me 22 shkurt 2014. Me aktivitete sindikale ka nisur të merret që në filltet e SBASHK-ut. Mundohet të jetë i përkushtuar dhe moto e punës së tij është bashkëbiseda me anëtarësinë.

Këtë e nisë duke kujtuar vazhdimisht thënien "Të jemi bashkë e në SBASHK". Pyetjeve të redaksisë për numrin festiv të gazetës sonë u është përgjigjur me kënaqësi.

Arsimimi Sot:

1. Kush është Rrahman Jasharaj?

z. Jasharaj:

U lindi më 6 dhjetor 1960 në fshatin Staradran të Burimit (Istogut). Kisha një fëmijëri të vështirë sepse familja ime shkoj për një kohë në Turqi e pastaj u kthyem në qytetin e Pejës. Nëna ime më shkolloi dhe falë asaj u bëra mësimdhënës. I premtova se do të angazhohem aq sa mundem e di dhe e mbajta premtimin. Në SBASHK jam që nga themelimi dhe jam munduar të jap kontributin tim bashkë me shumë veprimtarë të tjerë. Kolegët më bënë një nder të madh duke me zgjedhur në shkurtin e vitit 2014 kryetar të SBASHK-ut. Ju kam premtuar gjithë anëtarëve se do të angazhohem me tërë mundësitë dhe dijen time dhe kështu besoj edhe kam bërë falë edhe ndihmës që më kanë ofruar bashkëpunëtorët e mi në qendër dhe në gjithë komunat e Kosovës. Në kohën e lirë kam provuar të shoh nëse kam talent për të shkruar . Punova edhe si gazetar, botova dy libra dhe kam punuar edhe skenarë filmash. Tani gjithë kohën e kaloj në aktivitete të SBASHK-ut bashkë me shumë kolegë e kolege.

Arsimimi Sot:

2. Cilat ishin sfidat e këtij viti?

z. Jasharaj:

Viti 2015 për SBASHK-un ishte vit i arritjeve, por edhe i sfidave. Kemi shënuar arritje, por kemi edhe shumë për të bërë. U promovua kontrata individuale e punës, kërkesë kjo e vazhdueshme e SBASHK-ut, por, ja që disa DKA hezitojnë të veprojnë sipas udhëzimit të MASHT-it dhe krijojnë probleme të pa nevojshme me këto kontrata. Po ashtu sfidë ishte dhe mbetet mos përmblidhja e obligimeve të qeverive lokale lidhur me dhënien e tri pagave për të punësuarit në arsim me rastin e pensionimit të tyre dhe kompensimin prej 70 % të biletave të udhëtimit për mësimdhënësit udhëtarë. Sfidë e madhe mbetet edhe çështja e Ligjit mbi skemat pensionale të financuara nga shteti sepse ka defekte dhe të punësuarit në arsim po dalin në pensione të ndëshkuar sepse marrin 75 e jo 140 euro sa janë pensionet aktuale. Po ashtu sfidë mbetet edhe çështja e Ligjit për benifite për mësimdhënësit dhe të punësuarit tjerë në arsim në vitet 90-99. Ka edhe sfida të tjera dhe do të punojmë bashkërisht që t'i realizojmë një nga një. Sfidë mbeten edhe çështjet e ngritura me arsye nga kolegët tanë sindikalistë në Universitet dhe bashkërisht me ta do të angazhohemi që ato kërkesa të gjejnë zgjidhje meritore dhe në afat sa më të shpejtë.

Arsimimi Sot:

3. Sa herë gjatë këtij viti keni realizuar takime me anëtarësinë e SBASHK-ut?

z. Jasharaj:

Gjatë këtij viti kemi realizuar dy cikle vizitash nëpër të gjitha komunat e Kosovës dhe me pjesëmarrësit në takime kemi bashkëbiseduar për tema të caktuara për licencimin dhe ngritjen e vazhdueshme të cilësisë dhe për çështje aktuale kudo në shkollat tona. Kemi vlerësuar se këto takime kanë arritur qëllimin e tyre dhe se janë shumë të nevojshme. Kështu unë dhe kryesia e SBASHK-ut edhe në vitin e ardhshëm do të vazhdojmë me takime nëpër komuna, por edhe në shkolla të caktuara për të bashkëbiseduar nga afër me anëtarësinë. Jemi takuar edhe me udhëheqës dhe me kolegët tanë në Universitet.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



Arsimimi Sot:

4. Sugjerimet e dala nga takimet me anëtarë, sa keni arritur t'i adresoni?

z.Jasharaj:

Sugjerimet nga anëtarësia ishin që të vazhdojmë me takime të tilla dhe të vazhdojmë po ashtu me forcimin e unitetit dhe me përpjekjet për realizimin e kërkesave legjitime e të arsyeshme të anëtarësisë. Përkrahja që kemi hasur kudo në komuna nga anëtarësia jonë na shton forcën për t'u angazhuar edhe më shumë. Kërkesa e anëtarësisë i kemi adresuar në organet gjegjëse.

Arsimimi Sot:

5. Krahësuar me vitin 2014, këtë vit a ishte femra më aktive në veprimtaritë sindikale?

z.Jasharaj:

Po fatmirësisht ka arritje pozitive dhe femra mësimdhënëse është gjithnjë e më aktive edhe me pjesëmarrje në trajnime, por edhe në aktivitete të tjera sindikale. Një shembull i mirë është Mitrovica. Atje kryetare e Kuvendit të SAF e SAM është znj. Vjollca Shala dhe ajo me shembullin e saj ka dëshmuar se femra di të jetë aktive dhe të sjellë suksese edhe në sferat sindikale. Shembull si ky ka edhe në komunat tjera, por edhe në nivelin qendror dhe kjo është për t'u përshëndetur. Në të ardhmen femra mësimdhënëse, me siguri, do të jenë edhe më e pranishme dhe më aktive në gjithë veprimtaritë sindikale në nivel komash, Universiteti dhe në nivelin qendror.

Arsimimi Sot:

6. Sa keni arritur t'i përmbushni objektivat e këtij viti?

z.Jasharaj:

Janë shënuar arritje dhe për këtë na janë falënderuar edhe anëtarë të sindikatave tjera. Këto arritje janë të njohura kudo. Është shtuar prandaj dukshëm edhe numri i anëtarëve të rinj në SBASHK. Kemi arritur të nënshkruajmë 118 marrëveshje për zbritje çmimesh të shërbimeve për anëtarët tonë kudo në Kosovë e besa edhe në Shqipëri me biznese dhe me institucione private shëndetësore, rekreative dhe me institucione private arsimore. Këtë traditë të nënshkrimit të

marrëveshjeve në shërbim të anëtarësisë do ta vazhdojmë. Kemi arritur edhe objektiva të tjera, por kemi edhe shumë punë për të bërë.

Arsimimi Sot:

7. A jeni të kënaqur me dialogun social që keni zhvilluar gjatë këtij viti?

z.Jasharaj:

Jam pjesërisht i kënaqur me dialogun social që kemi zhvilluar këtë vit. Botërisht është parë se SBASHK-u i ka dhënë vazhdimisht rëndësi parësore dialogut dhe është munduar që gjërat të zgjidhen me dialog, por pala tjetër ishte më pak e përkushtuar. Kur mungon përkushtimi i dyanshëm atëherë mbetet vetëm një rrugë drejt zgjidhjes së çështjeve a ajo është me veprime sindikale.

Arsimimi Sot:

8. Cilat institucione të Kosovës ishin pro dialogut dhe cilat kishin hezitim për të dialoguar?

z.Jasharaj:

Shembull i mirë i dialogut ka qenë gjatë gjithë këtij viti Ministri Bajrami, por edhe gjithë kabineti i tij. Jemi takuar shpesh dhe kemi bërë përpjekje të përbashkëta për zgjidhjen e çështjeve, por Ministria e Financave dhe ajo për Punë dhe Mirëqenie sociale kanë heziturar të dialogojnë.

Arsimimi Sot:

9. A mund të na përmendni disa nga të arriturat (sukseset) e SBASHK-ut gjatë këtij viti që po lëmë pas?

z.Jasharaj:

Arritja më e madhe është uniteti i forcuar dhe bashkëbisedat e sinqerta me anëtarësinë. Kështu është krijuar besimi i ndërsjellë dhe kjo është me shumë domethënie për SBASHK-un. Po ashtu kemi arritur të tregojmë para opinionit dhe institucioneve vendore, por edhe para ndërkombëtarëve në Kosovë dhe miqve tanë të shumtë kudo në botë se jemi sindikatë mirë e organizuar dhe e vendosur në përpjekjet për të kryer misionin tonë.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsimit dhe Kulturës

KEC



Arsimimi Sot:

10. A keni diçka për të shtuar?

z.Jasharaj:

I përgëzoj të gjithë anëtarët e SBASHK-ut për qëndrimin dinjitoz gjatë veprimeve sindikale, për unitetin e shkëlqyer dhe i falënderoj për respektin që

po tregojnë ndaj nesh gjatë vizitave në selinë tonë dhe nëpër komunat e Kosovës. Të gjithë i përgëzoj për përfundimin e mbarë të gjysmëvjetorit të parë. Ju uroj të gjithëve një vit të ri të mbarë dhe Ju premtoj se bashkërisht e të pa luhatur do të vazhdojmë me angazhimet për të realizuar gjithë kërkesat tona.

Gjatë muajit

Takimi i Këshillit Drejtues të SBASHK-ut

Vërejtje të shumta ndaj institucioneve qendrore e lokale të shtetit



Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, por edhe anëtarët e Këshillit Drejtues duke përcjellë opinionet dhe zërin e mësimdhënësve nga gjithë komunat e Kosovës dhe nga Universiteti kanë bërë vërejtje të shumta në adresë të institucioneve qendrore e lokale të shtetit. Ata kanë kujtuar Kabinetin Qeveritar dhe organet e Universitetit se nëse nuk ka veprime konkrete lidhur me këto çështje atëherë do të ketë veprime sindikale, duke mos përjashtuar edhe grevën e përgjithshme që në janarin e vitit 2016.

Organi më i lartë i SBASHK-ut, Këshilli Drejtues ka mbajtur takimin përmbys për këtë vit. Fillimisht anëtarët e Këshillit Drejtues kanë analizuar raportin financiar janar-nëntor 2015 dhe janë shprehur se është bërë menaxhim i kujdesshëm dhe sipas planifikimit i mjetëve. Pas kësaj ata kanë aprovuar buxhetin për vitin 2016.

Pas kësaj kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj ka përgëzuar të gjithë të punësuarit në arsimin e Kosovës për punën e bërë dhe për përfundimin e gjysmëvjetorit të parë. Ai ka kujtuar pastaj për gjithë aktivitetet dhe arritjet që janë bërë në vitin 2015 duke i dhënë vend meritë edhe sfidave të shumta.



Kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, por edhe anëtarët e Këshillit Drejtues duke përcjellë opinionet dhe zërin e mësimdhënësve nga gjithë komunat e Kosovës kanë bërë vërejtje të shumta në adresë të institucioneve qendrore e lokale të shtetit. Ata kabinetin e kryeministrit Isa Mustafa e kanë kritikuar për mosmiratimin e Ligjit për të punësuarit në arsimin e Republikës së Kosovës në vitet 90-99, për moszbatimin e Ligjit mbi Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, Për mos fillimin e implementimit të Ligjit mbi Sigurimin Shëndetësor, për mos heqjen e defekteve në Ligjin mbi KES-in, për mos planifikimin në Buxhetin e vitit 2016 të mjetëve për implementimin e Ligjit për të punësuarit në arsimin shqip të Kosovës në vitet 90-99, për mungesë së gatishmërisë së duhur për dialog dhe për çështje tjera. Këshilli Drejtues ka kritikuar edhe organet e Universitetit për zvarritjen e nënshkrimit të Kontratës Kolektive për Universitetin, për mos mbajtjen premtimit lidhur me shkrirjen e stimulimit në pagën bazë dhe për mos llogaritjen e 0.5 % për vitet e shërbimit në pjesën e stimulimit. Kryesia e SBASHK-ut dhe Këshilli Drejtues në takimin e tyre kanë kujtuar Kabinetin Qeveritar dhe organe të udhëheqëse të Universitetit se nëse nuk ka veprime konkrete lidhur me këto çështje atëherë do të ketë veprime sindikale, duke mos përjashtuar edhe grevën e përgjithshme që në janarin e vitit 2016.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC





K³ shilli Drejtues ka ngritur nj³ varg kritikash edhe ndaj nivelit komunal të pushtetit duke përmendur mos respektimin e Udhëzimit Administrativ të MASHT-it lidhur me Kontratat individuale të punës nga disa DKA, Mos dhënie e tri pagave për të punësuarit në arsim me rastin e pensionit, mos kompensimit të 70 % të biletave të udhëtimit për mësimdhënësit udhëtarë dhe çështje të tjera.

Delegacioni i SBASHK-ut u takua me ministrin Bajrami **Bashkërisht do të angazhohemi edhe në vitin 2016**

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj i shoqëruar nga menaxheri për financa dhe këshilltari për organizim të brendshëm Ymer Ymeri janë pritur sot në MASHT nga ministri dr. prof. Arsim Bajrami dhe këshilltari i tij z. Azem Guri. Ministri Bajrami ka bërë një analizë të angazhimeve të MASHT-it dhe është ndalur veçmas te përpjekjet për ngritjen e cilësisë në arsim. Ai ka përgëzuar SBASHK-un për organizimin e suksesshëm të konferencës "Roli i SBASHK-ut dhe partnerëve në ngritjen e cilësisë në arsim".



"MASHT-i e konsideron SBASHK-un partner dhe bashkërisht do të angazhohen edhe në vitin 2016 në shërbim të arsimit" ka deklaruar ministri Bajrami duke shprehur gatishmërinë për bashkëpunimin korrekt. Ai ka shtruar idenë që edhe në vitin 2016 të organizohen konferenca për të debatuar jo vetëm për cilësinë por edhe për çështje sindikale. Delegacioni i SBASHK-ut ka lavdëruar angazhimet e ministrit Bajrami dhe kabinetit të tij për shumë çështje. Ata pastaj i kanë dorëzuar ministrit konkluzionet nga konferenca e lartpërmendur, por edhe një raport nga debati dhe qëndrimet e Këshillit Drejtues të SBASHK-ut që është mbajtur me 19 dhjetor 2015. SBASHK-u i dorëzoi ministrit Bajrami edhe një shkresë të SUSHK që kishte të bënte me shqetësimet e të punësuarve në administratën e Universitetit. Delegacioni i SBASHK-ut ka kërkuar nga ministri Bajrami që të vazhdoj me angazhimet në kabinetin qeveritar me qëllim që ligji për të punësuarit në arsimin e Republikës së Kosovës në vitet 90-99 të shkoj sa më shpejt në parlamentin e Kosovës për tu aprovuar.

Takim miqësor dhe i suksesshëm i SBASHK-ut me përfaqësues të GIZ **Bashkëpunimi vazhdon edhe në vitin 2016**

"Jam e impresionuar me angazhimin, korrektësinë tuaj, përkushtimin me zemër në shërbim të arsimit dhe me sukseset e Konferencës suaj "Roli i SBASHK-ut dhe partnerëve në ngritjen e cilësisë në arsim", është shprehur para delegacionit të SBASHK-ut, përgjegjësjë e GIZ-it gjerman, zonja Dagmar në selinë e kësaj

organizate që merret me përcjelljen e gjendjes në arsimin e Kosovës dhe kontribuon në ngritjen e cilësisë në arsim. Ajo është shprehur me respekt edhe për angazhimet e përbashkëta GIZ-SBASHK lidhur me takimet me mësimdhënësit në komunat e Kosovës dhe me arritjet nga këto takime për promovimin e

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



bashk³punimin korrekt e ka b³r³ n³ k³t³ takim edhe zyrtarja e GIZ, znj. Ukimeraj . Edhe kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj dhe menaxheri financiar e këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri kanë lavdëruar punën që ka bërë e po bën GIZ në shërbim të arsimit të Kosovës dhe kanë lavdëruar edhe bashkëpunimin e ndërsjellë. Ata pastaj kanë prezantuar idetë e SBASHK-ut për vazhdimin e bashkëpunimit me GIZ . Të dy palët janë pajtuar që bashkëpunimi do të vazhdojë dhe janë cekur edhe fushat e mundshme që do të detajizohen në planet e punës së GIZ dhe SBASHK për vitin 2016.



Gjykata e Ferizajt u njeh të drejtën e kompensimit të tre pagave pensionistëve **Çështjet më mirë të zgjidhen me dialog se me gjykatë**



Mos zbatimi i kontratës kolektive qon pensionistët që të drejtat e tyre që parashihen me kontratën kolektive të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit dhe SBASHK-ut, për pagesën e tre pagave pas pensionimit ti realizojnë përmes gjykatës. Pas daljes në pension sipas kësaj kontrate është e paraparë që atyre që sapo dalin në pension të marrin edhe tri paga. Por si duket kjo nuk po realizohet në Komunën e Ferizajt edhe pse ky vendim është në fuqi që nga 1 janari 2015.

Kjo ka shtyrë mësimdhënësin e sapo pensionuar Rexhep Ismanin që këtë të drejtë ta realizoi përmes gjykatës.

Me këtë rast Ismanit gjykata e Ferizajt i'a ka njohur këtë të drejtë dhe obligon Drejtorinë e Arsimit që ti

paguaj tre pagat të cilat sipas marrëveshjes u takojnë atyre që arrin moshën e pensionimit.

Për këtë edhe kryetari i SBASHK-ut në Ferizaj Rexhep Sadiku, në një prononcim për medie ka njoftuar për këtë rast si dhe ka ftuar të gjithë ata që arrijnë moshën e pensionimit nëse nuk u njihet kjo e drejtë nga organet komunale për realizimin e kësaj të drejte ti drejtohen gjykatës .

“Është mirë që të gjithë pensionistët të cilët kanë dal në pension nga data 11.04.2014 të gjithë tu drejtohen me shkrim organeve komunale ,Drejtorisë së Arsimit për realizimin e kësaj të drejte. Nëse ata nuk e marrin për bazë kërkesën e tyre ,atëherë tu drejtohen organeve gjyqësore për realizimin e kësaj të drejte” tha Rexhep Sadiku.

Sadiku ngriti edhe shqetësimin për pagesën e shpenzimeve të udhëtimit në lartësi deri 70 % për të cilin ende nuk po gjendet rruga për këtë. Ai kërkoi që tek punëtorët e arsimit të bëhet edhe kompensimi material për punëtorët e arsimit për periudhën e viteve të 90-ta e cila ende ka mbetur e padefinuar.

Në anën tjetër është bërë e ditur se komuna është duke shikuar mënyrën e këtyre kompensimeve për pagat e pensionit,si e drejtë e këtyre të fundit, e jo të shkohet përmes gjykatës e cila do ti kushtoi më shumë komunës.

SBASHK-u mori pjesë në Kongresin VI të Sindikatës së Arsimit të Maqedonisë Takime të shumta me përfaqësues sindikatash nga Ballkani dhe Evropa



Sindikata e Arsimit të Maqedonisë ka mbajtur këtë uaj Kongresin VI të tyre në të cilin kanë debatuar për çështjet aktuale duke caktuar edhe planin e angazhimeve për 5 vitet e ardhshme. Delegatët e këtij Kongresi kanë rizgjedhur z. Joakim Nedelkov për kryetar të kësaj sindikate në mandatin e ardhshëm 5 vjeçar. Në punimet e këtij Kongresi ka marrë pjesë edhe Ministri i Arsimit të këtij shteti, z. Abdilaqim Ademi dhe përfaqësues të tjerë të qeverisë maqedonase.

Sindikata e Arsimit të Maqedonisë (SONK) kishte nisur me aktivitetet para Kongresit, të cilat ua kishin dedikuar mysafirëve nga shtetet e Ballkanit dhe Evropës duke organizuar vizita në Strugë e Ohër në shenjë mikpritjeje.



Delegacioni i SBASHK-ut i përbërë nga kryetari Rrahman Jasharaj dhe menaxheri për financa e këshilltari për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri, krahas pjesëmarrjes në Kongres, qëndrimin në Strugë e kanë shfrytëzuar edhe për takime të shumta me përfaqësues të sindikatave nga shtetet e Ballkanit dhe Evropës. Me përfaqësues të sindikatës së Arsimit të Maqedonisë është biseduar për vazhdimin e bashkëpunimit për çka janë pajtuar të dy palët. Një

takim i veçantë ka qenë ai me delegacionin nga Sindikata shlovene e arsimit, që po kryesohej nga sekretari gjeneral dhe mik i vjetër i SBASHK-ut, z. Branimir Strukelj, i cili është edhe anëtarë në strukturat e larta të udhëheqjes së EI-së për Evropën. Në këtë takim është bashkëbiseduar për gjendjen në arsimin e të dy vendeve, por edhe në përgjithësi në Ballkan, Evropë dhe botë dhe është përsëritur nevoja që duke qenë në shërbim të anëtarësisë dhe arsimit në përgjithësi duhet vazhduar me bashkëpunimin dhe solidaritetin sindikal.



Delegacioni shloven është interesuar për aktivitetet e SBASHK-ut dhe për angazhimet në të ardhmen duke shprehur edhe një herë gatishmërinë për përkrahje dhe bashkëpunim miqësor mes të dy sindikatave. Delegacioni i SBASHK-ut ka pasur takim të veçantë edhe me përfaqësues të sindikatave të arsimit të Turqisë dhe me atë të Konfederatës sindikale të këtij shteti. Delegacioni turk ka shprehur gatishmërinë për një bashkëpunim të vazhdueshëm me SBASHK duke organizuar vizita studimore në të dy shtetet dhe duke parë se në cilat sfera mund të bashkëpunohet më shumë. Edhe përfaqësuesja e Sindikatës së Arsimit të Holandës (AOB) znj. Clazien Rodenburg ka ripërsëritur se mes AOB-së dhe SBASHK-ut ekziston një miqësi e vërtetë që nga kohët e vështira të arsimit të Kosovës në vitet e 90-ta e kjo miqësi po vazhdon e do të vazhdojë gjithmonë.

Delegacioni i SBASHK-ut ka pasur takime të ndara edhe me përfaqësues të sindikatave të arsimit nga Bullgaria, Mali i Zi dhe veprimtarë sindikalë shqiptarë nga Tetova dhe shumë qytete të tjera.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



SBASHK-u i pranishëm kudo flitet për arsimin në Kosovë Plani strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021



Duke dëshmuar se SBASHK-u përveç angazhimeve të vazhdueshme për realizimin e kërkesave legjitime të anëtarësisë dhe mbrojtjes së të drejtave të tyre ligjore nga shkeljet eventuale, është angazhuar ndër të parët dhe po vazhdon se angazhuari edhe në ngritjen e vazhdueshme të cilësisë, ku sindikata jonë ka organizuar Konferencën ndërkombëtare "Roli i SBASHK-ut dhe partnerëve në ngritjen e cilësisë në arsim". Kjo Konferencë ka shënuar arritje të mëdha duke bërë në të njëjtin vend Ministrin Bajrami dhe njohës të arsimit nga Sllovenia, Maqedonia, Shqipëria dhe Kosova. Kjo Konferencë është përmbyllur me rekomandimet dhe përfundimet që janë bazë e mirë për të zhvilluar aktivitete konkrete në të ardhmen. Krahas kësaj SBASHK-u vazhdon të jetë i pranishëm kudo flitet e vendoset për arsimin në Kosovë. Kështu përfaqësues të SBASHK-ut morën pjesë në takimin

njëditor të organizuar nga MASHT me temën kyçe "Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021" duke dhënë kontribut të çmuar në çështjet e ngritura. Po ashtu përfaqësues të SBASHK-ut ishin pjesë edhe e takimit për lansimin e Planit Strategjik për sigurimin e cilësisë në Arsimin Parauniversitar në Kosovë. Në këtë takim Ministri Arsim Bajrami ka theksuar se janë duke u bërë angazhime konkrete në ngritjen e vazhdueshme të cilësisë duke veçuar se këto përpjekje bëhen në mbështetje të plotë të miqve ndërkombëtar dhe të Qeverisë e cila ka aprovuar Planin Strategjik për ngritjen e cilësisë.

Në pjesën tematike të diskutimeve kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj ka deklaruar se shteti nuk mjafton ta shpall arsimin prioritet, por duhet të dëshmohej për këtë duke ndarë buxhet më shumë për të krijuar kushte pune e për të bërë të mundur ngritjen e vazhdueshme të cilësisë. Kryetari Jasharaj ka kujtuar institucionet se SBASHK-u vazhdimisht ka ndihmuar në ngritjen e cilësisë me angazhime e shembuj konkret, por do të përcjell rrjedhat me kujdes dhe nuk do të lejojë se angazhimet në këtë sferë të mbesin vetëm peshë mbi mësimdhënësit sepse, si tha ai, nëse mësuesi mbetet vetëm në gjithë këto angazhime, atëherë do ta ketë vështirë dhe arritjet nuk do të jenë ato të dëshiruara.

SBASHK-u vazhdon të lidh marrëveshje me bizneset në shërbim të anëtarësisë Në 118 ka arritur numri i tyre kudo në Kosovë



qendrore e SBASHK-ut vazhdojnë me nënshkrimin e marrëveshjeve të reja për zbritje çmimesh të shërbimeve në biznese private për anëtarësinë e SBASHK-ut.

Kështu pas marrëveshjes me Kompaninë "EURO

Kryetari i Kuvendit të SAF e SAM të Gjilanit, Blerim Mehmeti i përkrahur nga veprimtari sindikal Aliriza Osmani dhe kryesia

Goma SHPK" për zbritje çmimesh prej 25 % për produktet në këtë Kompani, janë nënshkruar marrëveshje edhe me NTP Auto pjesë "XIMI" të përfaqësuar nga z. Selami Kadriu dhe atë "BELNAS" të përfaqësuar nga Sejdi Qehaja. Marrëveshja me NTP "Ximi" sjell zbritje çmimesh prej 15 % për gjithë anëtarët e SBASHK-ut për këto shërbime këtu:

1. Servisim i të gjitha llojeve të veturave,
2. Ngjyrosje
3. Goma për të gjitha llojet e veturave, por edhe riparimin e gomave dhe
4. Auto-pjesë të të gjitha llojeve të veturave të reja, të vjetra dhe vajra, antifriz e produktet të tjera.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Marrëveshja me Ndërmarrjen NTP "Belnas" sjell zbritje çmimesh prej 10 % për :

1. Pajisje elektrike,
2. Për ujësjellës,
3. Për kanalizim,
4. Ngjyra,
5. Sanitari dhe

6. Të gjitha pajisjet shtëpiake. Ju kujtojmë se mësimdhënësit sindikalistë dhe anëtarët tjerë të sindikatës sonë me rastin e paraqitjes në këto ndërmarrje për të kërkuar shërbime me zbritje çmimesh sipas marrëveshjeve me ta duhet të identifikohen me kartelën e tyre sindikale dhe me lejen e njoftimit. SBASHK-u falënderon të 117 bizneset dhe institucionet private shëndetësore e rekreative për bashkëpunimin me SBASHK-u dhe për përkrahjen me zbritje çmimesh në shërbim të anëtarësisë sonë.



Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsimit dhe Kulturës

KEC

